



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Shk.Shk.II.nr.632/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Krenar Berisha kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri anëtar, në konfliktin administrativ-komercial, sipas padisë së paditësit, Kompania e Sigurimeve S... me seli në Prishtinë kundër të paditurit Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Ekonomisë Financave-Komisioni i Ankesave, me bazë juridike: anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.3139/2019 të datës 02.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.10.2022, merr këtë

### A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit Kompania e Sigurimeve S... me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.3139/2019 i datës 02.11.2021, PRISHET, dhe Lënda i kthehet Dhomës së Shkallës së parë Departamenti për Çështje Fiskale e Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në rigjykim dhe rivendosje.

### A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me Aktvendimin A.nr.3139/2019 të datës 02.11.2021, ka Hudhur Poshtë padin e paditësit Kompania e Sigurimeve S... me seli në Prishtinë, për shkak se paditësi nuk ka ushtruar ankesë ndaj aktvendimit 03nr.... dt.03.04.2019 të paditues Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Financave, me të cilin vendim i njëjti është ngarkuar me pagesën e taksës komunale për ushtrimin e aktivitetit afarist për vitin 2019, për lokacionin e biznesit në adresën Rr....në Ferizaj.

Kundër këtij Aktvendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë pala paditëse, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të prishet aktvendimi i atakuar, dhe qështjen t'ia kthej gjykatës në rigjykim dhe rivendosje ose të vendos që të pranohet padia e paditësit dhe të anulohet vendimi i paditurit Komisionit për ankesa i Komunës së Ferizajit, si të pabazuar. Është fakt i pa kontestuar se e paditura në procedurën administrative ka ngarkuar gabimisht dhe pa bazë paditësin me taksë komunale për ushtrimin e afarizmit në territorin e Komunës, për zyrën vendin e shitjes rruga ..... Ferizaj, paditësi në këtë pikë nuk ushtron veprimtarin afariste, nuk ka filial apo degë të saj. Meqë aktvendimi 03nr.... dt.03.04.2019 është dërguar në lokalitetin e biznesit individual S.sh.ne rrugën ....., dhe është kërkuar nga ai të paguaj tarifën pas konsultimeve dhe me autorizim të kompanisë S... me datë 11.07.2019 i njëjti ka ushtruar ankesë duke kundërshtuar aktvendimin si të pabazë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale në Prishtinë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 13 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 LKA-së, gjeti se ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri Komisioni i Ankesave-Komuna e Ferizajit me vendimin numër ... dt.18.11.2019, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën nr.... dt.11.07.2019 dhe ka obliguar Drejtorin e Financave që të veproi konform këtij vendimi.

Pala paditëse e pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurit Komisioni i Ankesave-Komuna e Ferizajit, ka ushtruar padi në konflikt administrativ me datë 30.12.2019, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit me numër ... dt.03.04.2019 i të paditurit, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, bie aktvendimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e Hudh poshtë për shkak se paditësi nuk ka ushtruar ankesë ndaj aktvendimit 03nr.... dt.03.04.2019 të paditues Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Financave, me të cilin vendim i njëjti është ngarkuar me pagesën e taksës komunale për ushtrimin e aktivitetit afarist për vitin 2019, për lokacionin e biznesit në adresën Rr....në Ferizaj. Në arsyetim të vendimit gjykata e shkallës së parë nxjerr konstatimin se personi S.Sh.me datë 11.07.2019 ka ushtruar ankesë tek e paditura dhe i njëjti operon si biznes dhe se nuk është filiale e paditësit, por është pikë shitëse e produkteve të sigurimit të ofruar nga paditësi, përkatësisht është ndërmjetësues në mardhënie kontraktuale sipas kontratës nr.../17 dt.28.12.2017. Në këtë situat gjykata konstaton se paditësi nuk ka provuar faktin se ka shteruar mjetet juridike të ankesës tek e paditura për taksën komunale, dhe në bazë të kësaj palë në procedurë administrative tek e paditura është dashur të jetë paditësi e jo S.Sh., prandaj gjykata ka marr Aktvendim per Hudhje posht të padis së paditësit

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktvendimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore të palës paditëse vëren se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n), dhe 183 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, se është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, dhe po ashtu jo i plotë lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike për çka në mënyrë të bazuar theksohet në ankes.

Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar me të cilin është Hudhur poshtë padia e paditësit, me arsyetimin se ankes në procedurën administrative te ankesave, ka ushtruar personi i pa autorizuar S.Sh., në emër të paditësit. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë vlereson se gjykata e shkallës së parë ka nxjerr konkluzion jo të drejt në aspektin e gjendjes faktike, ka bërë zbatim të gabuar dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lidhur me këtë çështje, për arsye se gjatë konfliktit administrativ nuk janë nxjerr prova të mjaftueshme për ta vërtetuar drejt gjendjen faktike lidhur me veprimet e palëve ndërgjyqëse gjatë procedimit administrativ.

Prandaj, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nuk mund ti përkrah si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se arsyet në të cilat bazohet për faktet vendimtare lidhur me mënyrën e vendosjes janë jo të qëndrueshme dhe në kundërshtim me faktet të cilat i theksoj paditësi në ankesë dhe procedurën administrative që e ka zhvilluar e paditura me rastin e marrjes së vendimit të kontestuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar është juridikisht i pa qartë dhe jo i drejtë lidhur me veprimet procedurale që i ka ndërmarr e paditura me rastin e komunikimit të tarifës komunale për vitin 2019 ndaj paditësit, i cili ushtron veprimtarin afariste në territorin e të paditues. Në aktvendimin 03 nr.... dt.03.04.2019 si obligues i pagesës së shumës së tarifës komunale është Kompania e Sigurimit S... SH.A me adresë Rr....., ndërsa pala e paditur të njëjtin vendim ia komunikon personit fizik S.Sh., në të njëjtën adresë, i cili në këtë rast është vetëm ndërmjetësues i palës paditëse S... sh.a. sipas Kontratës .../17 dt.28.12.2017, dhe nuk jepen informata të mëtejme se ky person që e ka pranuar vendimin 03 nr.... dt.03.04.2019, a është person i autorizuar i palës paditëse, dhe se ky komunikim i tarifës komunale, i është dorzuar në adresën e duhur palës paditëse. Edhe përfaqësuesi i autorizuar i të paditues në seancën gjyqësore datë 02.11.2021 para gjykatës, nuk e ka kontestuar ankesën e ushtruar nga personi S.sh.në procedurën administrative të ankesave, por vetëm ka theksuar se sipas evidencave të paditues, paditësi ka kontratën e punës me S.Sh. për shitjen e produkteve, në adresën e caktuar Rr ..... Paditësi ka paraqit gjykatës Autorizimin e datës 09.07.2019 me të cilin ka autorizuar S.sh.a përfaqësoj në Kuvendin Komunal në KK Ferizaj, për të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale dhe administrative në emër të KS S..., lidhur me taksën komunale për zhvillimin e aktivitetit afarist.

Prandaj Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi se në aktvendimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, nuk janë nxjerr të gjitha konstatimet faktike nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe nuk është provuar të vërtetohet se gjatë procedurës administrative janë zbatuar drejt nga e paditura dispozitat e Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Prandaj, bazuar në shkeljet e theksuara si më lartë, gjykata e shkallës së parë në ri-procedurë duhet të caktoj shqyrtimin gjyqësor dhe në prezencën e palëve ndërgjyqëse, të shqyrtoj ligjshmërinë e vendimit kontestues dhe të vendos lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që paraprakisht të vërtetoj rrethanat se e paditura ka adresuar aktet administrative, përfaqësuesit të autorizuar të paditësit në adresën e saktë ku ka njësinzyrën në Komunën e Ferizajit, për të vërtetuar faktet se e paditura ka zbatuar drejt dispozitat e nenit 110, 113, 119 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të shqyrtohen pretendimet ankimore se paditësi ka zyren në Ferizaj në Rrugën ....., si degë e paditësit që ka selin në Prishtinë, dhe se organi i paditur Komisioni i Ankesave i KK Ferizaj, ka nxjerr vendimin e kontestuar në pajtim me dispozitat e nenit 131 paragrafi 2 dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Për arsyet e dhëna më lart, aktvendimi i ankimuar është dashur që të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, ashtu që e njëjta në ri-procedurë në bazë të provave të administruara duhet të sqarojë dhe të vërtetojë të gjitha faktet në këtë çështje, dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike, si dhe eliminimit të shkeljeve të theksuara, gjykata e shkallës së parë duhet të vendos në këtë çështje me vendim të drejtë dhe ligjor.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, si dhe nenit 195 par.1 pika (c), të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.632/22 dt.06.10.2022

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari  
Krenar Berisha